



Rezoluta e punëtorëve dhe punëtoreve të mbledhur në Kuvendin e përgjithshëm më 4 Mars 2010 në Sindikatin SIT

Për ruajtjen (vazhdimin) e një Konvente për sigurim social në mes të Zvicrrës dhe Kosovës.

Anëtarët e Kuvendit kanë marrë njohuri për pasojat që përplasen mbi komunitetin Kosovarë pas denoncimit nga ana e Këshillit Federal të Konfederatës Zvicerrane të Konventës për sigurime sociale me shtetet e dala nga ish Jugosllavia që nga 01 Prilli i vitit 2010

Ky denoncim unilateral dhe jo i motivuar do të thotë se Zvicrra nuk ka paguar për raste të reja që jetojnë në Kosovë, pensionet që rrjedhin nga sigurimet e moshës, invaliditetit, aksidenteve profesionale dhe atyre joprofesionale.

Madje, shtesat familjare për fëmijët që janë në vendlindje do të ndërpriten brutalisht.

Kuvendi i përgjithshëm konstaton se :

- Komuniteti Kosovar në Zvicër perfshinë afër 200'000 persona dhe participon aktivisht për zhvillimin e vendit dhe këtë e bënë me dekada të tëra.
- Ky komunitet në masë të madhe punon në sektore si ai i ndërtimtarisë ku rreziku për shëndetin e tyre është i lartë
- Pensionet invalidore të cilat aktualisht dërgohen në Kosovë arrijnë në numrin 300, prej 300'000 pensioneve të cilat dërgohen nga ky sigurim dhe paraqet 1 pension ndër 1000. Edhe poqese do të kishte abuzime, këto do të ishin minimale dhe në masë të paperfillshme në proporcion me numrin e vogël të pensioneve invalidore të cilat dërgohen në Kosovë »
- Nuk është raportuar asnjë motiv serioz i cili do të arsyetonte një denoncim të përhershëm të tillë
- Ky denoncim për pasojë do të ketë pengimin e kthimit në vendlindje të punëtoreve dhe punëtorëve Kosovarë të moshuar ose të sëmurë (që në mënyrë indirekte paraqet një kosto të rëndësishme për sigurimet Zvicerrane)
- Kjo kategori e punëtorëve do të gjenden në situatë të qëndrimit të detyrueshëm në Zvicër, me pensione të cilat nuk mundesojnë një jetë dinjitoze
- Këto shtesa paraqesin një ndihmë shumë të madhe për edukimin e fëmijëve të mbetur në vendlindje.
- Ky vendim paraqet një diskriminim të paparë kundër një ndër komuniteteve më të rëndësishme në Zvicër.
- Ky vendim i Zvicrrës është burim i destabilizimit të Kosovës dhe është në kundërshtim të plotë me marrëdhëniet e bashkëpunimit të plotë dhe serioz si dhe me favorizimin e zhvillimit politik, social e ekonomik të Kosovës, si shtet i ri me kapacitete të ulta financiare.
- Zvicrra duhet të participojë në mënyrë aktive në përpjekjet ndërkombëtare për zhvillimin e një administrimi të qëndrueshëm të sigurimit social në Kosovë si element thelbësor për rindërtimin dhe ruajtjen e paqes në rajon.

Perabllë këtij vendimi tërësisht të padrejtë dhe të pakuptimtë, Kuvendi sindikal i sotëm kërkon që :

- Këshilli federal të hjek dorë nga denoncimi i kësaj Konvente për sigurime sociale;
- Konventa për sigurime sociale mes Zvicrrës dhe ish Jugosllavisë duhet të mbahet në mënyrë kalimtare;
- Një Konventë specifike me Kosovën duhet të negociohet, ashtu sikur aktualisht bëhen negociatat me Serbinë, Bosnjën dhe Malin e Zi, ose siq mund të jenë nënshkruar me Maqedoninë dhe Kroacinë.

Kuvendi sindikal i mbajtur më 4 Mars 2010 i fton të gjithë të nënshkruajnë peticionin e bashkangjitur dhe njëkohësisht Ju fton të merrni pjesë në mënyrë masovike në fushatën **PËR RUAJTJEN DHE VAZHDIMIN E NJË KONVENTE NË MES TË ZVICRRËS DHE KOSOVËS**

./.

Peticion i drejtuar Këshillit Federal të Konfederates Zvicerrane
dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

**PËR RUAJTJEN DHE VAZHDIMIN E NJË KONVENTE NË
MES TË ZVICRRS DHE KOSOVËS**

Ne, punëtorët nga Zvicra kërkojmë që :

- **Këshilli Federal të anulojë denoncimin e Konventes për sigurime sociale në mes të Zvicrës dhe ish Jugosllavisë**
- **Qeveritë e Zvicrës dhe Kosovës pa humbur kohë të fillojnë negociatat për nënshkrimin e një Konvente për sigurime sociale në mes të shtetit të Zvicrës dhe shtetit të Kosovës.**
- **Të vlejë Konventa për sigurime sociale e vitit 1962 në mes të Zvicrës dhe ish Jugosllavisë në mënyre kalimtare derisa të nënshkruhet një Konventë e re.**

Një Konvente e kështu do të ishte garant i të drejtave të punëtoreve dhe punëtorëve migrues të dy shteteve që dëshirojnë të kthehen në vendlindjet e tyre dhe të cilët shfrytëzojnë sigurimet pensionale të moshës, invaliditetit, aksidentit profesional dhe jo profesional dhe nga shtesat për femijtë e ngelur në vendlindje.

NOM	Prénom	Adresse	Signature

Kthe listen sa më shpejtë që të jetë e mundur, edhe nëse nuk është e plotësuar, më së voni deri me 20 Mars 2010 në këtë adresë :

Syndicat SIT, Rue des Chaudronniers 16, Case postale 3287, 1211 Genève 3